



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HAS

Shtojca 13.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT

[Data 27.11.2024]

Drejtuar: B.O.E SHPRESA - AL & OUEN me NUIS K31321021N / K175292150, me adrese ruga “Urani Pano”, pas Qendres VEVE, PALL. 11 katesh, kati 2, zyra nr.1- TIRANE- Kodi postar-1001 / Lagjja Shemri,Rruga Nacionale Shemri Kukes Km 2,Zona Kadastrale Ne 3335, Nr.Pasurie 593/1.

Operatorit Ekonomik (OE) ose

[Emri, Nipti dhe adresa e Operatorit Ekonomik]

Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE)

[Emrat, Nipt-et, % përkatëse dhe adresat e anëtarëve të BOE]

B.O.E SHPRESA - AL - K31321021N me perqindje 60% & OUEN - K175292150 me perqindje 40%, me adrese ruga “Urani Pano”, pas Qendres VEVE, PALL. 11 katesh, kati 2, zyra nr.1- TIRANE- Kodi postar-1001 / Lagjja Shemri,Rruga Nacionale Shemri Kukes Km 2,Zona Kadastrale Ne 3335, Nr.Pasurie 593/1.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO **JO**

Nëse po, të jepen dhënat: _____

[Emrat, Nipt-et, përkatëse dhe adresat]

Tipi i Kontratës: **Punë**

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e hapur / Punë / Me Mjete elektronike**

Numri i Procedurës / Referenca e Lotit: **REF-24220-10-13-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Sistemim asfaltim i rrugeve te brendshme Fshati Golaj”.**

Kohëzgjatja e kontratës: 12 muaj.

Data e Publikimit në SPE, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit: 20.11.2024

1Data e Publikimit në Buletinin e Njoftimeve Publike, të Njoftimit të Fituesit nga i cili nisin afatet e ankimit/Njoftimit të Anulimit nga i cili nisin afatet e ankimit Buletini Nr. 81 datë 25 Nëntor 2024.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

-oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Formulari, ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me vlerat përkatëse të ofruara:

1. ALKO IMPEX CONSTRUCTION

K91628013D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 0 (Zero)

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. ASI-2A CO

K53002402C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

¹ Në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore, plotësohet vetëm data e publikimit të këtyre njoftimeve në BNJP

Vlera 73,374,114.12 (Shtatedhjetë e tre milion e treqind e shtatedhjetë e katër mijë e njëqind e katërmbedhjetë pike dymbëdhjetë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. B.O.E "DENOLT" & BAMI HOLDING

K48021210Q / J94416206R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 64,691,941 (Gjashtëdhjetë e katër milion e gjashtëqind e nentëdhjetë e një mijë e nentëqind e dyzete e një) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. FUSHA

J61922018S

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 87,093,842.90 (Tetëdhjetë e shtatë milion e nentëdhjetë e tre mijë e tetëqind e dyzete e dy pike nentëdhjetë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

5. B.O.E SHPRESA - AL & OUEEN

K31321021N / K17529215O

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 83,951,496 (Tetëdhjetë e tre milion e nentëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind e nentëdhjetë e gjashtë) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

6. MELA.

K62320011G

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 78,426,404.20 (Shtatedhjete e tete milion e katerqind e njezete e gjashte mije e katerqind e kater pike njezete) Leke pa t.v.sh.

(e shprehur në shifra dhe fjalë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. ALKO IMPEX CONSTRUCTION

K91628013D

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it arsytet e mëposhtme

OE/BOE me nënkontraktor

PO JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Per arsyet e mëposhtme:

Se pari, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit i paraqitur nga ky operator ekonomik nuk është sipas formatit të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Publike dhe të publikuar në SPE nga Autoriteti Kontraktor.

Se dyti, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht: b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertes. Gjithashtu, nuk ka paraqitur Oferten Ekonomike, mungon Shtojca 1, 2 si dhe preventivi i punimeve.

Se treti, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht: **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (*pa TVSH*).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formularin e vlerësimit sipas Shtojcës 9;
- Kontratën e sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim
- Akti i Kolaudimit

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim
- Akti i Kolaudimit

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Për plotesimin e këtij kriteri ka paraqitur kontraten me objekt: “Mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Qendror dhe Verilindor – Kontrata B (330 Km)“, e cila është kontrate shërbimi dhe jo sipërmarrje. Për këtë objekt nuk është paraqitur Çertifikata e marrjes në dorezim, Akti i Kolaudimit si dhe tabela e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Se katërti, nuk plotëson kërkesat e vecanta për kualifikim, konkretisht: **2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:**

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë një punësim mesatar të paktën **60 (Gjashtedhjetë)** punonjesh me kohe të plotë duke përfshirë dhe stafin teknik, për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së ofertave. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mësipërme në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin, si më poshtë:
- Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën e mësipërme.
 - Listë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të paraqitura dhe të konfirmuara nëpërmjet formes elektronike nga organet tatimore për periudhën e mësipërme.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Ky operator ekonomik nuk ka përcaktuar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit numrin e punonjësve që disponon për periudhën e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor.

Se pesti, nuk plotëson kërkesat e vecanta për kualifikim, konkretisht:

- b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** të cilet të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

➤ Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastruktura 1 (një)

Për secilin pjesëtar të stafit inxhinierik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë (Drejtuesit teknik të jenë të siguar sipas legjislacionit në fuqi).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Ky operator ekonomik nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit se disponon Inxhinier Ndërtimi, profili Infrastruktura.

Se gjashti, nuk ploteson kërkesat e vecanta për kualifikim, konkretisht:

e) Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 16 (Gjashtëmbëdhjetë) punonjës të kualifikuar për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, Certificate trajnimi (të vlefshme), ose Dëshmi Profesionale lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për certifikimin e punonjësve, si dhe të figurojnë në listepagesat e shoqërisë, si më poshtë:

Teknik Ndertimi	1 (nje)
Teknik Topograf	1 (nje)
Asfaltoshtrues	3 (tre)
Specialist Ndertimi	3 (tre)

Shoferet për drejtim mjeteve duhet të jenë të pajisur me leje drejtimi me kategorinë "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

Për secilin pjesëtar të stafit teknik të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune të vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, diplomë profesionale / dëshmi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike / private të licencuara sipas Ligjit Nr.15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Shënim: Për shoferët, Operatori Ekonomik pjesëmarrës mund t'i disponojë edhe të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese". Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të plotësojë tabelën me të dhënat si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Nr kontrates Profesioni	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1				
2				
etj				

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevojë për tu kërkuar sqarime nga AK.

Ky operator ekonomik nuk ka deklaruar ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit se disponon personelin e kualifikuar sa me siper.

Se shtati, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht:

h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.

Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion ku te provoj se disponon Mjekun e shoqërise.

Se teti, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht:

2.3.4 Makineri Pajisje Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës se mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes 10-15 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Autovinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Autobetoniere	copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Autopompe	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Grejder	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Dumper	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Rrul vibrues gome cilinder mbi 18 ton pa percaktuar tonazhin	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Rrul cilinder cilinder me kompresor deri 10 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
12	Rrul cilinder gome me vibrim mbi 10 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera

14	Asfaltoshtruese	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Motogjenerator / Gjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Eskavator me zinxhir	copë	2	Në pronësi ose me qera
17	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Minieskavator/minifadrome	copë	2	Në pronësi ose me qera
20	Kontenier Stacioner	copë	2	Në pronësi ose me qera
21	Fabrike per prodhimin e materialeve inerte, te pajisur License nga QKL, Leje Mjedisore kategoria B	copë	1	Në pronësi ose me qera ose furnizimi
23	Impiant per prodhimin e Betonit, te pajisur me leje mjedisore nga QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronesine. Ne rast se impianti i prodhimit të betonit është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerase.	copë	1	Në pronësi ose me qera ose furnizimi
24	Rimorkiator mjetesh	copë	1	Në pronësi ose me qera
25	Tokmak per ngjeshje	copë	1	Në pronësi ose me qera
26	Vibrator betoni	copë	2	Në pronësi ose me qera
27	Instrument nivelues	copë	1	Në pronësi ose me qera
28	Sperkates boje per vijezi me ne rruge	copë	1	Në pronësi ose me qera

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e Rregullores për Sigurine në Kantier", si më poshtë vijon:

➤ Kokore minimumi

60 copë

- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 copë

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronësinë e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjeti (i vlefshëm).

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor sidhe të dekalroj dhe vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklarohet se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar në procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

Ky operator ekonomik nuk ka deklaruar në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit se disponon makinerite / pajisjet sa me sipër.

Gjithashtu nuk janë paraqitur deklaratat për verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve si dhe për mos angazhimin në kontrata të tjera.

Se nenti, nuk plotëson kërkesat e vecanta për kualifikim, konkretisht: **2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Se dhjeti, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht: **2.3.7** Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- Tuba celiku 2500 mm
- Tuba te brinjezuar HDPE SN8
- Bordura betoni

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhena të plota te prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë çertifikatë nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin per plotesimin e ketij kriteri.

Se njembdhjeti, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht: **2.3.8** Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 12 (dymbëdhjete) muaj kalendarike. Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur grafikun e punimeve.

Se dymbëdhjeti, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht: Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën **ku të shprehet se është dakort me menyren e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar**

nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues). Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Bashkise Has, e përcaktuar edhe tek Pika 2.10 e DST-së. Financimi është parashikuar në Buxhetin 2024-2026, afati i realizimit është 12 muaj.

Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur deklaratën sa me sipër.

2. ASI-2A CO

K53002402C

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme

* * *

OE/BOE me nënkontraktor

PO

JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve, Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Per arsyet e mëposhtme:

Se pari, nuk ploteson kërkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht: **2.3 Kapaciteti teknik:**

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formularin e vlerësimit sipas Shtojcës 9;
- Kontratën e sipërmarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim
- Akti i Kolaudimit

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë sipermarrje;
- Situacionin përfundimtar;
- Fatura tatimore;
- Çertifikaten e marrjes ne dorezim
- Akti i Kolaudimit

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 2.3.1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë: Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt “Objekt thertore 1 kat & impiant fotovoltaik 150 kW & Pajisje” me investitor Nikos Semanjakos PF.

Ky objekt rezulton se nuk perben “pune te ngjashme”. Zerat e preventivit te objekti qe prokurohet jane te ndryshem nga objekti qe operatori ekonomik ka paraqitur si pune te ngjashme. **(Referuar Vendimit 611/2020 te KPP). (Referuar Vendimit 539/2023 te KPP).**

Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt “Rikonstruksioni rruga varrezave Kuc” me investitor Bashkia Himare, me vlere 2,281,583 Leke.

Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt “Rikonstruksioni rruge te brendshme me beton” me investitor Bashkia Selenice, me sipermarres BOE “ASI-2A CO” sh.p.k. 25% dhe “Shendelli” sh.p.k. 75%, per te cilin nuk jane paraqitur faturat tatimore dhe nuk eshte paraqitur Kontrata e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt “Ndertim rruge e rrugica me beton” me investitor Bashkia Selenice, me sipermarres BOE “ASI-2A CO” sh.p.k. 95% dhe “Beqiri” sh.p.k. 5%, per te cilin nuk kane firmosur 2 anetare te grupit te marrjes ne dorezim, si dhe nuk eshte paraqitur kontrata e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt “Punime shtese tek tregu i gjese se gjalle” me investitor Bashkia Korce. Ky objekt rezulton se nuk perben “pune te ngjashme”. Zerat e preventivit te

objekti qe prokurohet jane te ndryshem nga objekti qe operatori ekonomik ka paraqitur si pune te ngjashme. **(Referuar Vendimit 611/2020 te KPP). (Referuar Vendimit 539/2023 te KPP).** Gjithashtu nuk kane firmosur 2 anetare te grupit te marrjes ne dorezim ne aktin e marrjes ne dorezim.

Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt “Postblloku nr.1 zyra e informacionit dhe rikonstruksion rruge ne Rep. Usht, nr.1040, Zall-Herr Tirane” me investitor Komanda e Forces Tokesore, per te cilin mungon situacioni perfundimtar, eshte paraqitur fotokopje pa ngjyra. Ky objekt rezulton se eshte realizuar ne bashkepunim me shoqerine Shendelli shpk e cila nuk ka firmosur ne aktin e marrjes ne dorezim. Mungon Akti i kolaudimit, pasi eshte paraqitur fotokopje pa ngjyra. Nuk eshte paraqitur kontrata e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.

Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt “NSHP, sistemim i territorit te ndermarrjes per NSHP viti 2023” me investitor Bashkia Vlore, me vlere 13,986,133 Leke.

Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt “Rikonstruksion i rruges Mirake – Gjovac, Nj. Ad. Polis” me investitor Bashkia Librazhd, me sipermarres BOE “ASI-2A CO” sh.p.k. 50.13% dhe “ZK Konstruksioni” sh.p.k. 49.87%. Shoqeria “ASI-2A CO” sh.p.k. nuk ka paraqitur faturat tatimore, ne kundershtrim me kerkesat e percaktuara nga autoriteti kontraktor.

Ky operator ekonomik ka paraqitur kontraten me objekt “Sistemim, asfaltim i rrugeve ekzistuese te aksit rrugore Letan – Bixelle, per te cilin nuk ka paraqitur faturat tatimore, ne kundershtrim me kerkesat e percaktuara nga autoriteti kontraktor.

Se dyti, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht: **h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.**

Ky operator ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacionin per disponimin e mjekut te shoqerise.

Se treti, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht:

2.3.4 Makineri Pajisje Operatori Ekonomik pjesëmarres duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës se mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
4	Autovinc	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Autobot uji	copë	1	Në pronësi ose me qera

21	Fabrike per prodhimin e materialeve inerte, te pajisur License nga QKL, Leje Mjedisore kategoria B	copë	1	Në pronësi ose me qera ose furnizimi
23	Impiant per prodhimin e Betonit, te pajisur me leje mjedisore nga QKL Kodi III.1.B) dhe dokumentacion që verteton pronesine. Ne rast se impianti i prodhimit të betonit është me qera duhet të paraqitet kontrata e qerase.	copë	1	Në pronësi ose me qera ose furnizimi

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin, si më poshtë:

Për mjetet që shenohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton pronesine e mjetit (akti i pronësisë); leje qarkullimi; çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); siguracion mjete (i vlefshëm).

Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: kontrata noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), leje qarkullimi; çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme), siguracion mjete (i vlefshëm).

Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjete dhe targa e tij.

Ky operator ekonomik nuk plotëson kriterin që kontrata noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës. Afati i realizimit të punimeve është percaktuar nga autoriteti kontraktor prej 12 muaj. Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit është 29/10/2024. Minimalisht afati i vlefshmerisë së kontratës së qerases duhet të jete data 29/10/2025. Sa me sipër, ky operator nuk ka arritur të plotësojë kërkesat për disponimin e makinerive / pajisjeve sa me sipër.

Se katërti, nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, konkretisht: **2.3.6** Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

Ky operator ekonomik nuk disponon Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”. Licenca LN-2888-09-2021 në objektin e saj nuk

perfshin grumbullimin e mbetjeve inerte por vetem transportimin e tyre. Pra, nuk ploteson kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor qe operatorët ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”.

3. B.O.E "DENOLT" & BAMI HOLDING

K48021210Q / J94416206R

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

arsyet e mëposhtme

* * *

OE/BOE me nënkontraktor

PO

JO

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Per arsyet e mëposhtme:

Se pari, nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht:

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Sipas marreveshjes se bashkepunimit, shoqeria Bami Holding sh.p.k. ka marr persiper 62% dhe Denolt sh.p.k. 38%. Sipas preventivit te ndarjes se punimeve shoqeria Denolt sh.p.k. ka marr persiper realizimin e punimeve me vlere 23,498,714 Leke pa tvsh, ose 36% dhe vlere e ofertes eshte 64,691,941 Leke pa tvsh.

Pra kemi nje perllogaritje gabim te perqindjes se pjesemarrjes te shoqerise Denolt shpk.

Nuk eshte bere e sakte ndarja e punimeve, pasi kemi mosperputhje te sasise totale te preventivit me sasite qe ka marr persiper te realizoj shoqeria Denolt sh.p.k.

Se dyti, ka gabim ne percaktimin e çmimit sipas shtojca 1, konkretisht shuma e shprehur me fjale e tejkalon dhjetefishin e fondit limit: Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: **77,630,329** [Shtateqind e shtatedhjet mijlon e gjashteqind e tridhjet mije e treqind e njezet e nente] Leke ;

Se treti, shoqeria Denolt sh.p.k. nuk ploteson kerkesat e vecanta per kualifikim, konkretisht:

